



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:124495

Datë: 23.03.2021

Numri i dokumentit: 01621393

C.nr.151/17

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Kaltrinë Haliti në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, kundër të paditurit B. A. nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti padi për rimbursimin e dëmit material dhe jomaterial me vlerë të kontestit 24.638,00€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesore dhe publik, më datën 18.03.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri B. A nga fshati ..., Komuna e Gjilanit që paditëses t’ia kompensoj mjetet në emër të borxhit- regresit shumën prej 24.638,00€, me kamatë 12% në vit nga dita e pagesës së dëmit deri në ditën e pagesës definitive të mjeteve në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm si dhe i ka kërkuar të gjitha shpenzimet e procedurës.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim si në shkresat e lëndës në këtë gjykatë me dt.02.02.2017 ka ushtruar padi kundër të paditurit me objekt kontesti regresimin e mjeteve në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material shumën në lartësi prej 24.638,00€, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri B. Anga fshati ..., Komuna e Gjilanit që paditëses t’ia kompensoj mjetet në emër të borxhit- regresit shumën prej 24.638,00€, me kamatë 12% në vit nga dita e pagesës së dëmit deri në ditën e pagesës definitive të mjeteve në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm si dhe i ka kërkuar të gjitha shpenzimet e procedurës.

Pas pranimit të padisë gjykata duke vepruar konform nenit 394 dhe 395 të LPK-së palës së paditur ia ka dërguar aktvendimin për përgjegje në padi.

Gjykata me dt. 29.08.2017 ka pranuar përgjegjjen në padi nga ana e të paditurit i cili në mes tjerash ka theksuar se kjo çështje fillimisht është trajtuar në procedurë penale ku i njejtë është liruar nga akuza dhe ndaj tij është vendosur me aktgjykim lirues sepse deri të aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimeve të këmbësorit- të ndjerit sepse i njejtë në mënyrë të befasishme dhe në vendin jo adekuat ka ndërmarr veprimin e kalimit të rrugës pa u siguruar paraprakisht se a janë përmbushur në tërësi kushtet për kalim të sigurt. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditëses si e pa bazuar e gjithashtu i ka kërkuar shpënzimet e procedurës.

Palët ndërgjygjëse për shkak të parimit të efikasiteti dhe ekonomizimit të procedurës i kanë propozuar gjykatës që të kalohet nga seanca përgaditore në konvokim të sencës për shqyrtimin kryesor të çështjes duke u bazuar në nenin 420.3 të LPK –së, të cilin propozim gjykata me aktvendim procedural e ka pranuar.

Përfaqësuesi i paditëses në shqyrtimin përgaditor, kryesorë dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke theksuar se nga administrimi i provave është vërtetuar se me dt. 01.06.2011 afër orës 11:25 në Gjilan në rrugën e Kamenicës kishte ndodhur aksident komunikacioni ku në bazë të raportit policor, skicës së bashkangjitur si dhe ekspertizës së aksidentit të komunikacionit të punuar në procedurën civile ishte konstatuar se shkaktar kryesorë i këtij aksidenti me veprimet e tij është tani i padituri ku i njejtë nuk kishte përshatur shpejtësinë e lëvizjes për atë pjesë të rrugës dhe nuk e kishte vërejtur këmbësorin me kohë dhe në pamundësi të ndajles së automjetit kishte aksidentuar këmbësorin tani të ndjerin N.Sh.R ku i njejtë kishte mbetur i vdekur në vendin e ngjarjes. Në momentin e aksidentit paditësi nuk posedonte kategorinë përkatëse për drejtimin e mjetit transportues bazuar në rregullin 3 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia neni 14 par.1 alinea 1.2 i njejtë humb mbulesën siguruese në momentin kur drejton automjetin pa kategorinë përkatëse mirëpo në kuptim të nenit 14 alinea 3 siguruasi pas përmbushjes së detyrimit ndaj palëve të dëmtuara ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e tyre ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

I padituri shqyrtimin përgaditor, kryesorë dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë përgjegjjes në padi i cili e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses në mungesë të bazë ligjore të kësaj padie. I njejtë ka shtuar se sa i përket kësaj çështje se unë veten e ndjej të pafajshëm pasi që me aktgjykimin penal me nr.PA.1nr.1693/12 të dt.14.06.2013 të Gjykatës së Apelit jam shpallur i pafajshëm dhe jam liruar nga përgjegjësia penale. Po ashtu i njejtë e ka kundërshtuar edhe provën të cilën e ka dorëzuar i autorizuar i paditëses sepse nga superekspertiza e komunikacionit e datës 05.06.2012 është precaktuar se deri te aksidenti ka ardhur nga lëshimet e këmbësorit sepse i njejtë në mënyrë të befasishme edhe në vendin joadekuat ka ndërmarr veprimin e kalimit të rrugës pa u siguruar paraprakisht se a janë plotësuar kushtet për kalim të sigurt. Po ashtu i njejtë i ka kundërshtuar edhe thëniet e përfaqësuesit të paditëses sepse nuk është e mundur që shpejtësia e lëvizjes së kamionit të ketë qenë 80 km/h spese nga pika e nisjes e deri te ndodhja e aksidentit distanca ka qenë dikund 80-100m, andaj duke pasur parasysh edhe peshën e kamionit kjo shpetjësia nuk është e

mundur të arrihet në një distancë kaq të shkurtër. Në fund i njejt i ka propozaur gjykaëts që padinë dhe kërkësëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazaur pasi që veten nuk e ndien fajtor lidhur me aksidentin e komunikacionit e gjithashtu edhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës vërtetonë pajfajsin e tij.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Raporti i Policisë me nr.Cr-... i datës 01.05.2011; Skica nga vendi i ngjarjes; Çertifikata e vdekjes në emër të N. S. R e datës 02.06.2011 lëshaur nga Departamenti i Mjeksisë ligjore; Çertifiakta e vdekjes në emër të N. Sh. R e datës 17.06.2011, lëshaur nga ZGJC në Gjilan; Çertifiakta e martesës me nr.... e datës 27.06.2011; Deklarata e bashkësis familjare me nr.... e dt.21.06.2011; Pajtimi gjyqësor i datës 13.02.2015 në lëndën civile me C.nr....; Urdhëresa për transfer e kompanisë K.S.”Kosova e Re” er datës 20.03.2015 në shumë prej 12,500.00€; Urdhëresa për transfer e kompanisë K.S.”Kosova e Re” e datës 08.04.2015 në shumë prej 11.169,60€; urdhëresa për transfer e kompanisë K.S.”Kosova e re” e datës 17.04.2015 në shumë prej 8,921 €, Urdhëresat për transfer e kompanisë K.S “Kosova e Re” e datgës në shumë prej 12.480.86€ e datës 30.04./2015 ; ftesa për pagesën e regresit nga K.S “Kosova e Re” e datës 22.03.2016 si dhe Aktgjykimi penal me nr.PA 1 nr.... i datës 14.06.2013 dhe superekspertiza mbik aksidentin e komunikacionit e datës 05.06.2012:

Gjykata pas vlerësimit te pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave te nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar dhe ka vendsour si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në rastin konkret, nuk ka qenë kontestus fakti se me datën 01.06.2011 rreth orës 11.25 min në Gjilan në rrugën nga Gjilani për Kamenicë afër “Drini Market” është shkaktuar aksident komunkacioni me fatalitet ku ka humbur jetën këmbësori N. R nga fshati ..., Komuan e Kamenicës, po ashtu nuk është kontestuse se këmbësori tani i ndjeri e ka shkaktuar këtë aksident me lëshimet e tij, por kontestuse është baza ligjore e kërkesëpadisë.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata ka vërtetuar faktin se deri te aksidenti ka ardhur me fajin e këmbësëorit-tani të ndjerit N. R i cila ka kaluar rrugën pa kujdes dhe në mënyër të paparitur derisa kamioni ka qenë shumë afër tij në largësi jo më shumë se 12 m ka dalur në rrugë dhe është futur nën rrotat e kamionit. I njëjti ka dalur në mënyrë të pa kujdesëshme në vendin ku nuk ekziston vendkalimi për këmbësorë, duke mos pasur kujdes ndaj kamionit MAN të cilin e kishte në afërsi dhe i cili lëvizte nga ana e majtë e tij në rrugën në të cilën ai tentonte ta truponte. Sikur të shiqonte në anën e majtë ai do të vërente kamionin në afërsi dhe me atë rast vetvetiu do të hiqte dorë nga kalimi i rrugës pasi që do të bindej se e kishte të pamundur kalmin në mënyër të sigurt fakt ky i vërtetuar edhe nga ekspertiza e datës 30.07.2014.

Po ashtu gjykata me Aktgjykimin penal me nr.PA 1 nr.... i datës 14.06.2013, vërtetoi faktin se ish Gjykata Komunale në Gjilan me aktgjykimn P.nr.... të dt.23.08.2012 të pandehurin tani të

paditurin B. A e ka liruar nga akuza ndërsa edhe pas ankesës së Prokurorisë Komunanle në Gjilan Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PA1.nr.... të dt.14.06.2013 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorit Publik Komunal në Gjilan kurse Aktgjyimin e Gjykatës Komunale e ka vërtetuar.

Gjykata pasi i ka shqyrtuar dhe vlerësuar edhe pretenimet e paditëses respektviisht të autorizuarit të saj për kompensimin e mjeteve në emër të borxhit-regresit në shumën e lartcekur ka ardhur në përfundim se e njehta duhet të refuzohet si e pabazuar në mungesë të bazës ligjore –juridike e cila është e paraparë te përmbajtja e padisë konkretisht neni neni 253 par.1 pika e) të LPK-ës, si dhe neni 14 i LPK-së parasheh se “Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”, e në rastin konkret i pandehuri-tani i padituri B. A nga fshati ... është liruar nga akuza.

Gjykata ka çmuar se kërkesëpdia e paditëses nuk e ka themelësinë në prova materiale, me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar baza juridike dhe aq ma pak lartësia e kërkesëpadisë. Në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit. Po ashtu nuk është vërtetuar shkaktimi i dëmit, përgjegjësia e të paditurit për dëmin e pretenduar, veprimin e paligjshëm të të paditurit (i padituri ka përgjegjësi subjektive apo objektive). Gjykata vlerëson se shkaktimi i dëmit është kushti me rëndësi për lindjen e detyrimeve për shpërblim. Ai është vendimtar për krijimin e përgjegjësisë juridike civile për dëmin e shkaktuar, sepse rreth tij sillen dhe rezultojnë të gjitha kushtet e tjera që kanë të bëjnë me këtë përgjegjësi. Shkaktimi i dëmit, si fakt juridik, paraqet rrethanë të caktuar e cila sjell deri te krijimi, ndryshimi apo ndërprerja e marrëdhënies së detyrimeve, ndërsa në rastin konkret shtrohet pyetja me çka është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit dhe me cilat prova është vërtetuar lartësia e saj. Një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, është edhe lidhja kauzale që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Në rastin konkret nuk kemi lidhmëri ndërmjet veprimit dhe pasojës së pretenduar tek paditësi. Nuk janë plotësuar kushtet ligjore për ta detyruar të paditurin për kompenzimin e dëmit të pretenduar nga ana e paditësit, përkatësisht të parapara në nenet 136, 137, 140, 169 dhe 173 të LMD-së. Pra në rastin konkret nuk kemi as dëm real as fitim të humbur, pasi që në rastin konkret i padituri është liruar nga akuza.

Gjykata vlerëson se sa i përket përgjegjësisë në shaktimin e aktidentit të datës 01.06.2011 përgjegjësisë së paditëses më pastaj për kompensimin e palës së dëmtuar në emër të të paditurit, këto fakte me rëndësi dhe vendimtare në këtë çështje kontestimore ka detyrim ti provojë dhe vërtetoj paditësja, në bazë të nenit 319 dhe 322 të LPK-ës, kur parashihet se **“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provjë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta si dhe “Në qoftese gjykata në bazë të provave të marruar (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”**. Në qoftë se Gjykata si në rastin konkret nuk mund të kosntatoj faktet me rëndësi të përshkruara më lartë, atëherë ajo kosntaton se cila prej palëve ndërgjyqëse ka pasur barrën e të provuarit të fakteve të lartë cekura e që është paditësja.

Me mos vërtetimin e faktit me rëndësi siq është baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses, Gjykata vendos për refuzimin e saj.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridiko kontestimore.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 450 të LPK-së ku secila palë është e obliguar ti bartë shpenzimet e veta të krijuara në raport me këtë kontest civil, pasi që paditësja e ka humbur procesin ndërsa i padituri nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e cekura me lart dhe bazuar në dispozitat e nenit 14 lidhur me nenin 253 par.1 pika e) të LPK-se, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.151/17, dt. 18.03.2021

Gjyqtarja,
Kaltrinë HALITI

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit, përmesë kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:124495
Datë: 23.03.2021
Numri i dokumentit: 01621393